



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.541/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.07.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Shendelli” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-07331-04-19-2017, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve te brendshme dhe KUZ Fshati Moravë”, me fond limit 4.181.667 lekë pa tvsh vlera pjesore për 2017 dhe 13.469.167 lekë pa tvsh vlera e plotë, zhvilluar më datë 12.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat.

Ankimues: “Shendelli” shpk
Lagjia “Kastriot”, Rruga “Andon Profka”,
“2 Kullat”, Fier.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Berat
Lagjia “Iliria”, Berat.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator i ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.04.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-07331-04-19-2017, me objekt “*Rikonstruksioni i rrugëve te brendshme dhe KUZ Fshati Moravë*”, me fond limit 4.181.667 lekë pa tvsh vlera pjesore për 2017 dhe 13.469.167 lekë pa tvsh vlera e plotë, zhvilluar më datë 12.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat.

II.2. Në datën 12.05.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 26.05.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- | | |
|-----------|-------------------------|
| - B 93 II | nuk ka paraqitur ofertë |
| - Kaexh | nuk ka paraqitur ofertë |

- Elira	8.439.909 lekë	i skualifikuar
- Fled	9.047.525 lekë	i skualifikuar
- Spektri	9.994.055 lekë	i skualifikuar
- Shendelli	10.624.685 lekë	i skualifikuar
- T& T Beton	10.744.718 lekë	i skualifikuar
- B-93	11.570.250 lekë	i skualifikuar
- Totila	13.422.331 lekë	i kualifikuar

II.4. Në datën 26.05.2017 operatori ekonomik “Shendelli” shpk, është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

“për kamionin me targa SR 2857B mungon kontrata e qirasë”.

II.5. Në datën 29.05.2017 operatori ekonomik “Shendelli” shpk., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor. Konkretisht ankimuesi në ankesën e tij pretendon si më poshtë:

“Operatori ekonomik “Shendelli” shpk ka paraqitur kontratën e qirasë për mjetin me targa SR 2857B. Rrjedhimisht arsyeja e skualifikimit nuk qëndron.”.

II.6. Në datën 31.05.2017, me shkresën nr. 2543/1 prot, operatori ekonomik ankimues “Shendelli” shpk është vënë në dijeni në lidhje refuzimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 08.06.2017 operatori ekonomik ankimues “Shendelli” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.2761/2 prot, datë 14.06.2017 protokolluar me tonën me numër 1078/2, datë 19.06.2017 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se *“për kamionin me targa SR 2857B mungon kontrata e qirasë”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në Shtojcën 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 4 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

”Deshmi për mjetet e pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës :

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Rule 20 tone me vibrim</i>	<i>2 cope</i>
<i>2</i>	<i>Mjete transporti veteshkarkues min.15 ton</i>	<i>2cope</i>
<i>3</i>	<i>Motobetonere</i>	<i>2 cope</i>
<i>4</i>	<i>Kamjocine</i>	<i>2 cope</i>
<i>5</i>	<i>Depozita uji kapacitet 5 000 litra</i>	<i>1 cope</i>
<i>6</i>	<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>1 cope</i>
<i>7</i>	<i>Eskavator</i>	<i>2 cope</i>
<i>8</i>	<i>Mjete Transporti me vinc</i>	<i>1 cope</i>
<i>9</i>	<i>Greider</i>	<i>1 cope</i>
<i>10</i>	<i>Mjete Transporti jo veteshkarkues min 12ton</i>	<i>1cope</i>
<i>11</i>	<i>Bobcat</i>	<i>1cope</i>
<i>12</i>	<i>Vibrator Betoni</i>	<i>2cope</i>
<i>13</i>	<i>Fadrome</i>	<i>1cope</i>
<i>14</i>	<i>Minieskavator</i>	<i>1cope</i>
<i>15</i>	<i>Tabela Sigurie</i>	<i>5 cope</i>
<i>16</i>	<i>Ndricues rrugor</i>	<i>2cope</i>

- Makineri - pajisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuara, në rast të pronësive, me qera të shoqërohen me kontratat e noterizuara të qera ”.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik ankimues “Shendelli” sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë::

- *Kontratë qiraje lidhur para një noteri publik me nr.rep.1084 dhe nr.kol.508, lidhur më datë 27.06.2016, ndërnjet “Shendelli” shpk në rolin e qiramarrësit dhe “Jody-Kompany” shpk” në rolin e qiradhënësit, e vlefshme për një afat 10 vjeçar - deri më 27.06.2017; me objekt dhënien me qira të disa mjeteve, ndër të tjera dhe mjetin me targa SR 2857B.*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma "b", të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*

b. aftësia teknike: operatorët ekonomike vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike , aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [....].

III.1.4. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 28 “Kontratat e shërbimëe”, pika 2 përcaktohet: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Sa më sipër, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se në përmbushje të kërkesës së autoritetit kontraktor ku operatori ekonomik që disponon mjete me qera, duhet ta vërtetojë këtë me anë të kontratës së noterizuar të qirasë; rezulton se operatori ekonomik ankimues “Shendelli”shpk, ka dorëzuar dokumentacionin në fjalë për mjetin me targa SR 2857B.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” shpk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shendelli” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-07331-04-19-2017, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve te brendshme dhe KUZ Fshati Moravë”, me fond limit 4.181.667 lekë pa tvsh vlera pjesore për 2017 dhe 13.469.167 lekë pa tvsh vlera e plotë, zhvilluar më datë 12.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Shendelli” shpk duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomike “Shendelli” shpk.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1078 Protokoli, Datë 08.06.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha